



01/Nr. 1024 /2020  
Data: 10.02.2020

## PROCESVERBALI I KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA

Nga mbledhja e parë -I- për vitin 2020 e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur me datë 21.01.2020 me fillim pune në ora 11:00 në sallën e takimeve. Të pranishëm ishin: Mallzum Qajani (Nënkryetar i Komunës), Shabi Rexhallari (Drejtor për Buxhet dhe Financa), Edon Curri (Drejtor për Administratë), Sevime Laçi (Drejtoreshë për Zhvillim Ekonomik), Menduh Vlashi (Drejtor për Arsim , Kulturë, Rini dhe Sport), Medina Imishti (Drejtoreshë për Shëndetësi dhe Mirëqenie, Sociale), Nexhmedin Daci (Drejtor për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit), Ibrahim Axhami (Asistent i Kryesuesit të Kuvendit të Komunës), Bashkim Sopa (Zyrtar për Transparencë), Përfaqësuesi i OSB-së . Kryesuesi pasi konstatoi prezencën e anëtarëve të KPF-së, konstatoi se nuk mungon asnjë anëtarë i Komitetit për Politikë dhe Financa.

### RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Shqyrtimi i propozim vendimit për ndarjen e mjeteve financiare me rastin e termetit në Republikën e Shqipërisë.
3. Shqyrtimi i propozim vendimit për ndarjen e mjeteve financiare për bursa për studentë në komunën e Hani të Elezit për vitin akademik 2019/2020.
4. Shqyrtimi i planit të punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2020.
5. Shqyrtimi i planit të punës së tri komiteteve konsultative për vitin 2020.
6. Shqyrtimi i planit të punës së këshillave të fshatrave për vitin 2020.
7. Shqyrtimi i informatës mbi veprimtaritë afariste.
8. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson:- për pikat e rendit të punës hapi diskutimin.

Mehmet Ballazhi thekson:-pika e katërt, pesë dhe gjashtë e rendit të punës sipas materialeve që i kam shikuar gati se njëjtë janë dhe pak ndryshojnë te komitetet konsultative, ndërsa plani i punës së Komitetit për Komunitete nuk i përmbushë nevojat e komunitetit sipas planit për shkak se është një lloj i përshkrimit të planit të kuvendit të komunës se sa vetë Komitetit për Komunitete. Unë mendoj që këto tri pika me hyjë me një pikë komplet. Në objektivat të cilat janë paraparë në këto plane nuk ka diçka konkrete. Vitin e kaluar kemi biseduar me kryesuesit e komiteteve që me organizuar trajnimin.

Kryesuesi thekson:- ne kemi miratuar planin e punës së kuvendit të komunës për vitin 2020 dhe duhet të zbatohet sepse i kemi planifikuar veç e veç si pika te rendit të ditës. Planin e punës së Komitetit për Komunitete është komplet plan i punës së kuvendit të komunës , ndërsa planet e komiteteve konsultative disa ja kanë përshtatë natyrës së komitetit.

**Kryesuesi** thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri (prezent ishin të gjithë anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa).

## MIRATOHET RENDI I PUNËS

### 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

**Kryesuesi** thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri (prezent ishin të gjithë anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa).

## MIRATOHET PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR

### 2. Shqyrtimi i propozim vendimit për ndarjen e mjeteve financiare me rastin e termetit në Republikën e Shqipërisë.

**Kryesuesi** thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Mallzum Qajani** thekson:- ne i kemi parë ngjarjet lidhur me tërmetin që ka ndodhur në Shqipëri, mirëpo për shkak të mungesës së mjeteve financiare në vitin 2019 kemi propozuar për me ndarë mjete financiare në mënyrë që të solidarizohemi me ata qytetarë që kanë pësuar nga tërmeti dhe ajo shumë të jetë 10 000 €. Nëse keni ndonjë vërejtje mund të parashtroni.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- është mirë që është bërë propozimi por shuma që është propozuar nuk e di si është përcaktuar dhe a ka ndonjë arsye për shkak se është një shumë e vogël ndihmë për Shqipërinë, e kjo shumë nuk ka ndonjë ndikim të madh në buxhet.

**Mallzum Qajani** thekson:- jemi solidarizuar dhe nuk jemi mundu të jemi shumë modest por edhe mos të japim shumë hapt për shkak se si komunë nuk kemi buxhet shumë të madh, mirëpo nëse krahasohen edhe komunat e tjera jemi në mesin e shumë komunave të cilat i kanë ndarë nga 10 000 € por ka komunë që është shumë më e madhe dhe i ka ndarë 5000 €. Kjo shumë të cilën kemi propozuar me ndarë ndoshta mund ta ndërtojë një gjysmë shtëpie një familjes së vogël.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- ne e kuptojmë që shuma prej 10 000 € nuk mund të bëhet diçka por më shumë është solidarizimi. Unë mendoj që të ndahen 5000 € pasi janë subvencione dhe transfere, kurse shumën tjetër prej 5000 € me paraparë diku tjetër me subvencionuar. E them këtë sepse pasi nuk kryenë punë 10 000 € dhe ka komuna që kanë buxhet më të madh se komuna jonë dhe kanë ndarë mjete në shumë prej 5000 € dhe është mirë që me menduar që me ndihmuar diku tjetër për shkak se e di që ka pasur kërkesa nga shoqata e bletarisë me i ndihmuar për me i subvencionuar por nuk janë përkrahur nga komuna. Si pikë të rendit të punës e përkrahim që të kalon për kuvend dhe pastaj e diskutojmë.

**Kryesuesi** thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri (prezent ishin të gjithë anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa).

**U VOTUA PROPOZIM VENDIMI PËR NNDARJEN E MJETEVE FINANCIARE ME RASTIN E TERMETIT NE SHQIPËRI QË TË PËRCILLET PËR KUVEND**

### 3. Shqyrtimi i propozim vendimit për ndarjen e mjeteve financiare për bursa për studentë në komunën e Hanit të Elezit për vitin akademik 2019/2020.

**Kryesuesi** thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Menduh Vlashi** thekson:- materialin e keni pranuar me kohë dhe nëse keni ndonjë vërejtje mund të parashtroni.

**Teuta Shkreta** thekson:- është mirë që komuna të analizon për kuadrin deficitare dhe t'i përcakton si prioritet në të ardhmen.

**Menduh Vlashi** thekson:- në rregullore nuk janë përcaktuar prioritet por e kem potencuar që për çdo vit këshilltarët me vlerësuar se për cilat drejtime kemi nevojë dhe i përcakton në prioritet.

**Sabedin Hasallari** thekson:- studentët të cilat kanë marr bursë në vitin e parë a kanë përparësi në vitin e dytë dhe a e kanë pasur suksese studentët?

**Menduh Vlashi** thekson:- në vitin e kaluar kanë marr bursë të gjithë kurse sa i përketë suksesit në momentin që do të shpallet konkursi ata të cilët kanë pasur suksese aplikojnë përsëri kurse ata të cilët e kanë përsëritur vitin nuk aplikojnë.

**Nora Xhoni** thekson:- te kuadrat deficitare si prioritet është mirë me hyjë edhe Fakulteti Gjuhës Angleze dhe Fakulteti i Gjuhës Gjermane sepse në Han të Elezit është pak mungesë.

**Kryesuesi** thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri (prezent ishin të gjithë anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa).

**U VOTUA PROPOZIM VENDIMI PËR NDARJE E MJETEVE PËR BURSA PËR STUDENTË NË KOMUNËN E HANIT TË ELEZIT PËR VITIN AKADEMIK 2019/2020 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND**

### 4. Shqyrtimi i planit të punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2020.

**Kryesuesi** thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- shumica e pikave të këtij plani janë nga plani i kuvendit dhe po e bënë një lloj paralelizmi edhe pse nuk na pengon kjo por nuk e di a e arrinë qëllimin e punës së këtij komiteti. Ne e kemi diskutuar disa herë në kuvend që me i marr përgjegjësitë ky komitet për me vepruar që të ketë një rezultat që me i përfaqësuar interesat e komunitetit. Është mirë që me organizuar trajnime me anëtarët e Komitetit për Komunitete dhe me anëtarët e komiteteve konsultative.

**Kryesuesi** thekson:- është dashur më shumë pika me i planifikuar për komunitet e jo me i diskutuar pikat të cilat janë paraprë në plan të kuvendit të komunës .

**Mallzum Qajani** thekson:- është komitet obligativ dhe në ato komuna ku ka komunitete është më aktiv ndërsa në ato komuna ku nuk ka minoritet është më pasiv. Nëse duan me gjetë tema mund të gjinden tema që mund të prekin interesin e fshatrave dhe të grupeve të ndryshme të interesit. Te çështja e formulimit të temave më mirë do të ishte me bërë diskutim se sa shqyrtim sepse kuvendi i komunës i shqyrton dhe i miraton. Sidoqoftë pasi anëtarët e komitetit kanë planifikuar këtë numër të mbledhjeve dhe të temave është mirë që të mbëten ashtu siq i kanë paraprë.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- qëllimi i gjithë neve është që me pasur një rezultat dhe të plani i Komitetit për Komunitet më mirë do të ishte që me i pasur dy apo tri objektiva brenda vitit që jemi dhe me i elaboruar duke bërë kërkesa të ndryshme për me u realizuar varësisht prej kërkesave që ata i marrin prej komuniteteve .

**Kryesuesi** thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri (prezent ishin të gjithë anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa).

#### U VOTUA PLANI I PUNËS SË KOMITETIT PËR KOMUNITETE PËR VITIN 2020

### 5. Shqyrtimi i planit të punës së tri komiteteve konsultative për vitin 2020.

**Kryesuesi** thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri (prezent ishin të gjithë anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa).

#### U VOTUA PLANI I PUNËS SË TRI KOMITETEVE KONSULTATIVE PËR VITIN 2020 QË TË ËPRCILLET PËR KUVEND

### 6. Shqyrtimi i planit të punës së këshillave të fshatrave për vitin 2020.

**Kryesuesi** thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Edon Curri** thekson:- përveq materialit që e kam dërguar diçka të veçantë nuk kam. Nëse keni ndonjë vërejtje mund të parashtroni.

**Teuta Shkreta** thekson:- këshillat e fshatrave kanë shumë punë sepse për një fshat duhet ta dinë se sa banorë i ka, cila rrugë është e dëmtuar , çështjen e ndriqimit, çështjet sociale të banorëve të atij fshati. Këto këshilla kanë obligim që të merren me infrastrukturën e fshatrave dhe kërkesat e banorëve me i prezentuar me shkrim në organet përkatëse komunale.

**Kryesuesi** thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri (prezent ishin të gjithë anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa).

#### U VOTUA PLANI I PUNËS SË KËSHILLAVE TË FSHATRAVE PËR VITIN 2020 QË TË ËPRCILLET PËR KUVEND

### 7. Shqyrtimi i informatës mbi veprimtaritë afariste.

**Kryesuesi** thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Sevime Laçi** thekson:- përveq materialit të cilin e kemi përcjellë nuk kam diçka të veçantë.

**Nora Xhoni** thekson:- inkasimi i mjeteve financiare për vitin 2019 a është në rritje më shumë se viteve të tjera dhe strukturën e bizneseve është mirë me i paraqitur me ngjyra.

**Sabedin Hasallari** thekson:- në vitin 2018 ishin 275 biznese, ndërsa në vitin 2019 35 biznese që kur të mblidhen dali 310 biznese. Kërkoj sqarim për këtë çështje. Planifikimet ashtu siç i keni bërë janë inkasuar, mirëpo a janë inkasuar vetëm për vitin 2019 apo janë inkasuar edhe borgjet nga vitet e tjera.

**Sevime Laçi** thekson:- janë inkasuar edhe borgjet prej viteve të tjera, sa i përket numrit të bizneseve është një gabim teknik dhe do ta përmirësojmë.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- cilat janë pikat që ju si Drejtoreshë për Zhvillim Ekonomik planifikoni me i pasur prioritet për zhvillimin ekonomik? Struktura e biznesve është paraqitur mirë me përqindje por kur të bazohemi te prodhimi është 2 % dhe është shumë shqetësuese nëse e krahasojmë me bizneset transportuese të cilat janë 20 % po të analizohen të gjitha janë më shumë përveç se ndërmarrjet prodhuese dhe bujqësia janë 2 % dhe 1 % që do të thotë aty ku varet zhvillimi ekonomik përqindja është shumë e vogël .

**Sevime Laçi** thekson:- sa i përket zhvillimit ekonomik më shumë duhet të përkrahet bujqësia dhe bizneset fillestare. Ju e dini që kemi pasur edhe gurëthyesin “Bajarmaliu” dhe është mbyllur dhe nuk kemi mundësi me iu ndihmuar. Në bujqësi ka pasur shumë biznese të cilat kanë përfituar prej “Labit” dhe nuk i kanë regjistruar bizneset. Vitin e kaluar ishin 19 përfitues të cilët krahas përfitimit në pajisje e kanë regjistruar biznesin.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- asnjë biznes i huaj nuk vepron në Han të Elezit që sa vite sepse nuk iu ka mundësuar me vepruar për shkak se nuk janë joshur dhe nuk është krijuar infrastruktura cilado qoftë ajo për me paur investime të huaja këtu.

**Kryesuesi** thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri (prezent ishin të gjithë anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa).

#### U VOTUA INFORMATA PËR VEPRIMTARITË AFARISTE QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

### 8. Të ndryshme.

**Kryesuesi** thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- edhe në mbledhjen e kaluar e kam diskutuar çështjen e trafos në fshatin Pustenic për shkak se ka shumë probleme me çështje të rrymës atje dhe kjo çështje duhet të merret më seriozisht, duhet të shikohen mundësitë edhe për çështje të kanalizimit për shkak se ajo pjesë ka filluar me u ndërtuar.

**Mallzum Qajani** thekson:- sa i përket çështjes së trafos të gjitha ato mjete të cilat komuna investon kalojnë në pronësi të KEDS-it dhe realisht me diskutuar KEDS-i është i obliguar me rregulluar trafon në Pustenic. Sot është diskutuar edhe me ia ndërruar kahjen e rrymës për fshatin në Pustenic . Ne kemi bërë investime dhe të gjitha kanë kaluar në pronësi të KEDS-it.

**Kryesuesi** thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka shpalli të mbyllur mbledhjen.

Ju faleminderit për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi në ora 12:05

Procesmbajtësi

Ayni Bushi

